



REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
ELBASAN

Nr 2481 Prot

Elbasan më 11.04.2023

NJOFTIM

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan.

Zj./Z.-----

Ju njoftojmë se më datë 20.04.2023, ora 11:00 zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak Elbasan e thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të Ligjit 139/2015, neni 53 pika 4), në sallën e mbledhjeve të shkollës së mesme "Luigj Gurakuqi" me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së Mbledhjes.
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të muajit Mars (dt.28.03.2023).
3. Dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë Elbasan për muajin Mars 2023.
- 3/1. Dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Mars 2023.
4. Për heqjen nga fondi pyjor dhe kullësor publik dhe pakësimin në volum të sipërfaqeve që do të përdoren nga shoqëria "Vëllezrit Hysa" sh.p.k, për kryerjen e aktivitetit minerar në objektin "Gjorma", Bashkia Elbasan.
5. Mbi miratimin në parim të "Binjakëzimit" midis: Bashkisë Elbasan dhe Bashkisë së Narliderses, Turqi.
6. Për miratimin e marrëveshjes dhe vendosjen e bustit.
7. Mbi marrjen me qira të një mjeti (rinovim kontrate) për plotësimin e nevojave të transportit të administratës së Bashkisë Elbasan.
8. Mbi dhënie në përdorim, pa kundërshpërblim, (rivovim kontrate) të disa ambjenteve të ish-konviktit të shkollës "Onufri", Shoqërisë "Ujësjiellës-Kanalizime" Elbasan sh.a, nga Bashkia Elbasan.
9. Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z.Rexhep Veliraj, banor "Lagjen Vullnetari", Rajoni 4 dhe dhënie e shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan.
10. Korigjim i të ardhurave të trashëguara dhe i shpenzimeve në buxhetin e vitit 2023"
11. Mbi riemërtimin e Qendrës së Formimit Profesional dhe rishqyrtimin e vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.37, datë 27.04.2006.
12. Dhënie titulli "Qytetar Nderi" i Elbasanit.
- 12/1. Dhënie titulli "Qytetar Nderi" i Elbasanit.
- 12/2. Dhënie titulli "Qytetar Nderi" i Elbasanit
13. Për miratimin e themelimit të shoqatës "Grupi Vendor i Veprimit Egnatia".
14. Mbi miratimin në parim të "Memorandumit të Mirëkuptimit", "Rrjeti i Qyteteve për Ballkanin Perëndimor".



15. Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit, me interes publik "Rikonstruksion i rrugëve "Faik Pajuni" dhe "Alush Lleshanaku" në Z.K 8521, nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi.

Të ndryshme,

1. Për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të thjeshtuar, Bashkia Elbasan.
2. Mbi miratimin e disa aktiviteteve të Federatës Shqiptare të Çiklizmit.
3. Dhënie titulli "Qytetar Nderi" i Elbasanit.
4. Mbi miratimin e marrëveshjes ndërmjet shoqatës "Maraton Albania" dhe Bashkisë Elbasan për zhvillimin e aktivitetit: " Maraton Skampa 2023".
5. Dëgjesë më të rinjtë e Elbasanit.

Vo.Komisionet do të mblidhen ditën e enjte më datë 13.04.2023 ora 13:00 në ambientet e Bashkisë Elbasan me adresë konvikti i shkollës 'Pedagogjike'.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN
Hektor ÇIFTJA